



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 31.3.2023

Nr: 226

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

LIRIM DHE EMËRIM TË ANËTARIT TË KZAZ NR. 18, BASHKIA BULQIZË, ANËTARIT TË KZAZ NR. 48 DHE ANËTARIT TË KZAZ NR. 49, BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “ç” dhe 2, nenit 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Në bazë të nenit 32, pika 2, shkronja “d” të Kodit Zgjedhor, Partia e Lirisë, me shkresat nr. 2234 dhe nr. 2260 prot., datë 30.03.2023, ka kërkuar zëvendësime të anëtarëve të KZAZ-ve si më poshtë referuar:

- Në KZAZ nr. 18, ka kërkuar lirimin nga detyra e anëtarit z. Veap Mejdin Halili dhe zëvendësimin e tij me z. Justin Arjan Tafçiu.
- Në KZAZ nr. 48, ka kërkuar lirimin nga detyra e anëtarit z. Klajdi Ramazan Shtylla dhe zëvendësimin e tij me z. Bruno Qani Kalemi.
- Në KZAZ nr. 49, ka kërkuar lirimin nga detyra e anëtarit z. Andi Ramazan Shtylla dhe zëvendësimin e tij me zj. Brunilda Shaban Ballkoçi.

Propozimet dhe kandidaturat e paraqitura, plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të Kodit Zgjedhor.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “ç” dhe 2, nenet 30, 31, dhe 32, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Lirim nga detyra të anëtarit të KZAZ-së nr. 18, z. Veap Mejdin Halili, Bashkia Bulqizë, anëtarit të KZAZ-së nr. 48, z. Klajdi Ramazan Shtylla, anëtarit të KZAZ nr. 49, z. Andi Ramazan Shtylla, Bashkia Elbasan.
2. Emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr. 18, z. Justin Arjan Tafçiu, Bashkia Bulqizë, anëtarit të KZAZ-së nr. 48, z. Bruno Qani Kalemi, anëtarit të KZAZ nr. 49, zj. Brunilda Shaban Ballkoçi, Bashkia Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i njoftohet KZAZ-së përkatëse.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI